



KOMUNIKATË PËR SHYTYP

11 maj 2018

KSC5-18

Listat e dyta të Mbrojtësve të Specializuar dhe Mbrojtësve të Viktimave

Sot, më 11 maj, Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë shtuar në Lista emrat e mbrojtësve, krahas mbrojtësve që ishin pranuar më parë. Regjistrimi në këto Lista bën që këta avokatë të kenë mundësinë të zgjidhen për t'u paraqitur para DHSK-së për të përfaqësuar të dyshuar, të akuzuar, një grup viktimash, apo çdo person tjetër që ka të drejtën e përfaqësimit ligjor në bazë të [Ligjit](#) për krijimin e DHSK-së dhe të [Direktivës për Mbrojtësit](#). Listat e publikuara përmbajnë emrat e 87 profesionistëve të fushës së drejtësisë nga Kosova, Serbia, dhe një numër vendesh të tjera. Mbrojtësit mund të zgjedhin nëse duan që emrat e tyre të përmenden në faqen e internetit të DHSK-së.

Ky është raundi i dytë i njoftimeve, pas Listave të shpallura më 14 mars 2017. Listat publike të mbrojtësve mund të shihen në [tabelën](#) që gjendet në faqen e internetit të DHSK-së.

Me këtë rast, Kryetarja e DHSK-së, gjykatëse Ekaterina Trendafilova, përgëzon të gjithë kandidatët dhe kandidatet dhe thekson mesazhin e saj se kriteret e rrepta për pranim në këto lista janë garanci që të pandehurit dhe viktimat do të kenë mundësinë të përfaqësohen në mënyrë profesionale dhe efektive para DHSK-së, çka do të kontribuojë më tej për forcimin e integritetit të administrimit të drejtësisë nga ana e Dhomave të Specializuara.

Që nga nëntori 2017 kur filloi ky proces, Zyra e Mbrojtjes dhe Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave kanë marrë kërkesa të shumta për pranime në lista. Shqyrtimi i kërkesave dhe procesi i pranimi të mbrojtësve vazhdon. Si rrjedhojë, këto Lista të Mbrojtësve do të përditësohen vazhdimisht dhe në to do të pranohen edhe kandidatë të tjerë ndërkohë që vazhdon procesi i shqyrtimit të kandidaturave të tyre. Pra, **procesi do të mbetet i hapur**.

Hollësitë në lidhje me pranimin mund t'i gjeni tek [Udhëzuesi për plotësimin e formularit](#).

KONTAKTI:

Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun e Dhomave të Specializuara në:
mediaKSC@scp-ks.org, numri i telefonit: +31(0)6 249 21 036

Për më shumë informacion në lidhje me Dhomat e Specializuara të Kosovës, vizitoni:
www.scp-ks.org